

**Vendim nr. 172 datë 19.07.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 19.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (Sh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **SHOQËRIA “SIONTIS” S.A., SHOQËRIA “DESIGN AND CONSTRUCTION SIONTIS” S.A., CHRISTOS SIONTIS (KRISTOS SIONTIS),** të përfaqësuar nga avokatët Avni Shehu dhe Bashkim Dedja, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 49, datë 15.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-17 (4), datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe protokolle nr. 1 i saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Shoqëritë “Siontis” s.a dhe “Design and Construction Siontis” s.a. janë persona juridikë të së drejtës greke, me seli në qytetin e Janinës dhe me administrator kërkuesin Christos Siontis (Kristos Siontis).

2. Midis shoqërisë “Design and Construction Siontis” s.a., në cilësinë e sipërmarrësit dhe shoqërisë “Gjallica Company” sh.p.k., në cilësinë e porositësit, në datat 04.04.1996 dhe 10.08.1996 janë nënshkruar dy kontrata, respektivisht për ndërtimin e objektit “Business Center Albania” në qytetin e Vlorës, me kosto punimesh në vlerën 3.300.000 USD dhe për ndërtimin e fabrikës së tullave në Vlorë, me kosto punimesh në vlerën 1.300.000 USD. Për këtë qëllim, shoqëria “Gjallica Company” sh.p.k. ka kaluar në favor të kërkueseve shuma të caktuara të hollash.

3. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8188, datë 23.01.1997 “Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes”, aktiviteti i shoqërisë “Gjallica Company” sh.p.k. është ndërprerë. Në bazë të ligjit nr. 8215, datë 09.05.1997 “Për nxjerrjen e detyrimeve debitorëve dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogaritë e personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, shoqëria Gjallica Company” sh.p.k. është vendosur në administrim (*shoqëria në administrim*), duke iu nënshtruar kontrollit financiar.

4. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 44, datë 21.01.1999, mes të tjerave, ka deklaruar edhe shoqërinë “Siontis” s.a. si person juridik të lidhur me shoqërinë huamarrëse “Gjallica Company” sh.p.k. Vendimi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 8 të muajit mars të vitit 1999.

5. Në vijim, pas shqyrtimit të dokumentacionit, administratorët e përbashkët të shoqërisë në administrim, me vendimin nr. 15, datë 11.08.1999, kanë deklaruar debitorë shoqërinë “Siontis” s.a. dhe administratorin e saj Christos Siontis për shumën 295.920.000 lekë. Për këtë vendim, titull ekzekutiv sipas ligjit të posaçëm, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 835 akti, datë 18.4.2008, ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e tij.

6. Gjithashtu, administratorët e përbashkët të shoqërisë në administrim, me vendimin nr. 2, datë 07.09.2009, kanë deklaruar debitorë shoqërinë “Design and Construction Siontis” s.a dhe administratorin e saj Christos Siontis për shumën 1.700.000 USD. Edhe për këtë

vendim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 911 akti, datë 25.03.2010, ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e tij.

7. Në datën 03.05.2010 administratorët e përbashkët të shoqërisë në administrim i janë drejtuar Zyrës Përbarimore Elbasan për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutivë për të cilët Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimet si më lart, kishte lëshuar urdhrat e ekzekutimit. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, Zyra Përbarimore Elbasan, me vendimin nr. 1396-1397-10, datë 02.06.2010, ka vendosur masën e sekuestros për disa sende të luajtshme të debitorit Christos Siontis, për të cilat ky i fundit, si kreditor, ishte në procedurë ekzekutimi të vendimit nr. 509, datë 19.03.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Vendimi i sekuestros iu është komunikuar kërkuesve debitorë në datën 14.06.2010, sipas letërporosisë së nënshkruar nga përfaqësuesi i zgjedhur nga kërkuesi Christos Siontis, njëherësh edhe administrator i dy shoqërive debitore.

8. Në datën 17.06.2010 kërkuesi Christos Siontis i është drejtuar gjykatës së apelit me një padi me objekt kundërshtimin e veprimeve përbarimore të datës 02.06.2010 për vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë e luajtshme dhe anulimin e këtij vendimi. Në këtë rast është kërkuar edhe pezullimi i vendimit të sekuestros dhe i titullit ekzekutiv, vendimit nr. 2, datë 07.09.2009 të administratorëve të përbashkët të shoqërisë në administrim, si dhe urdhërimi i Zyrës së Përbarimit Elbasan të ekzekutojë vendimin nr. 509, datë 19.03.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë (me të cilin është ndryshuar vendimi nr. 10798, datë 15.12.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 28, datë 20.09.2010, ka vendosur rrëzimin e padisë.

9. Po në datën 17.06.2010, kërkuesi “Siontis Design and Construction” s.a i është drejtuar gjykatës së apelit me një padi me objekt: i) kundërshtimin e veprimeve përbarimore të datës 02.06.2010 për vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë e luajtshme dhe anulimin e tij; ii) kundërshtimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 2, datë 07.09.2009 të administratorëve të përbashkët të shoqërisë në administrim dhe anulimin e tij; iii) rivendosjen në afat të padisë. Për këtë padi, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 27, datë 15.09.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit të saj, për shkak të mosparaqitjes të paditësit (kërkuesit) në seancë gjyqësore, pa shkaqe të përligjura.

10. Në datën 21.06.2010, kërkuesi “Siontis” s.a. i është drejtuar gjykatës së apelit me një padi me objekt: i) kundërshtimin e veprimeve përbarimore të datës 02.06.2010 për vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë e luajtshme dhe anulimin e tij; (ii) kundërshtimin e titullit ekzekutiv, vendimit nr. 15, datë 11.08.1999 të administratorëve të përbashkët të

shoqërisë në administrim dhe anulimin e tij; (iii) rivendosjen në afat të padisë. Gjatë gjykimit të kësaj çështje, gjykata e apelit ka vendosur bashkimin e saj me çështjen e vënë në lëvizje në datën 04.11.2010 nga kërkuesi “Siontis Design and Construction” s.a., me të njëjtën padi si më lart. Po ashtu, gjykata e apelit ka vendosur edhe pranimin e kërkesës së datës 09.02.2011, për ndërhyrje kryesore të kërkuesit tjetër Christos Siontis, duke shqyrtuar edhe padinë e paraqitur nga ai në këtë rast.

11. Në përfundim të shqyrtimit të padive të kërkuesve, si më lart, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 15, datë 12.04.2011, ka vendosur rrëzimin e tyre. Mbi rekursin e kërkuesve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-1251 (379) datë 09.06.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

12. Në rigjykim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 18.06.2016, ka vendosur ndarjen e kërkit për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit nga kërkimet për: kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit gjyqësor të datës 02.06.2010 për vendosjen e masës së sekuestros për sendet e luajtshme dhe anulimin e këtij vendimi; kundërshtimin e titujve ekzekutivë, vendimeve nr. 15, datë 11.08.1999 dhe nr. 2, datë 07.09.2009 të administratorëve të përbashkët të shoqërisë në administrim dhe anulimin e tyre.

13. Në vijim, në lidhje me kërkimin për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 49, datë 15.11.2016, ka vendosur rrëzimin e tij. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur rekurs.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-17 (4), datë 11.01.2024, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 49, datë 15.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

15. Në datën 10.05.2024, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm, i cili është regjistruar në datën 16.05.2024. Në vijim, ata kanë paraqitur dokumente deri në datën 07.06.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesve

16. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se është cenuar:

16.1. *E drejta e aksesit*, pasi nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare për themelin e pretendimeve nga gjykatat, të cilat megjithëse kanë arsyetuar se kërkuesit nuk kanë pasur dijeni për aktet administrative, kanë rrëzuar kërkesën për të

rivendosur në afat të drejtën për t'i kundërshtuar ato, duke u mohuar përfundimisht aksesin në gjykatë. Gjykatat, megjithëse pranojnë se kërkuessit nuk kanë pasur dijeni për aktet administrative të nxjerra ndaj tyre si debitorë apo vendimet gjyqësore, kanë rrëzuar kërkesën e tyre për rivendosjen në afat të së drejtës për t'i kundërshtuar ato. Ato duhet të kishin vendosur pranimin e kërkesës për rivendosje në afat dhe të vazhdonin gjykimin e çështjes në themel.

16.2. *Parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, siguria juridike dhe pritshmëritë e ligjshme*, pasi gjykatat nuk kanë kompetencë lëndore për të gjykuar mosmarrëveshjen, e cila është me natyrë civile dhe jo administrative, sepse kërkimet lidhen me kundërshtimin e titullit ekzekutiv, që mbart një detyrim që buron nga kontratat. Kërkuessit kanë përcaktuar në kontratat e lidhura mes tyre se mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Arbitrazhit të Huaj në Paris. Ky parashikim në kontratë i bën vendimet e administratorëve dhe të gjykatës të pavlefshme, si dhe i heq mundësinë shoqërisë në administrim për të nxjerrë vendimet e saj, pa iu drejtuar më parë organit kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Përveç kësaj, nuk ka asnjë dispozitë ligjore që kompetencat e Gjykatës së Apelit Tiranë i kalojnë Gjykatës Administrative të Apelit. Po ashtu, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka bazuar vendimin në nenin 151 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), përmbajtja e të cilit ka qenë e ndryshme me atë në kohën e ngritjes së padisë në vitin 2010, sipas të cilit padia për rivendosjen në afat mund të ngrihej. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur parasysh nenin 109 të ligjit nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 38/2017), i ndryshuar, ku parashikohej se çështjet që ishin në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vijonin të gjykoreshin sipas dispozitave të ligjit në fuqi. Zbatimi i ligjit procedural që nuk ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së padisë e bën procesin të parregullt, pasi shkel *parimin e zbatimit të ligjit në kohë dhe të sigurisë juridike*.

16.3. *Parimi i kontradiktoritetit dhe i mbrojtjes*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka pranuar të shqyrtojë provat e rëndësishme që kanë paraqitur kërkuessit. Në dosjen gjyqësore janë administruar si prova vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë dhe të Gjykatës së Apelit Janinë, që kanë arsyetuar se vendimet e gjykatave shqiptare janë të paekzekutueshme në territorin e Greqisë, pasi

kërkuesve iu është mohuar e drejta e mbrojtjes. Sipas gjykatave greke është shkelur konventa midis Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale për sa i përket komunikimit të dokumenteve që lidhen me ekzistencën e detyrimit, duke mos pasur mundësi kërkuesit të mbrohen. Vetëm fakti që kërkuesit kanë marrë dijeni për vendimet e administratorëve nuk është i mjaftueshëm, përderisa nuk janë njoftuar të gjitha aktet dhe provat që kanë të bëjnë me vendime të tilla. Vendimet e gjykatave greke jo vetëm nuk janë marrë parasysh, por edhe formalisht nuk janë pasqyruar në vendimet e Gjykatës së Apelit ose të Gjykatës së Lartë.

16.4. *Parimi i ligjshmërisë, shtetit ligjor dhe hierarkisë së akteve dhe organeve*, pasi Gjykata Administrative e Apelit në rigjykim nuk ka respektuar detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 493 të KPC-së.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesve

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae* në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse janë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

19. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që

pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

20. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se shkelja e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në çdo aspekt të saj, mund të pretendohet në Gjykatë pas shterimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeliemeve. Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë, bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 25.04.2017; nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës së aksesit, të parimit të sigurisë juridike e pritshmërive të ligjshme, të së drejtës për t’u mbrojtur, të parimit të kontradiktoritetit, të parimit të ligjshmërisë, të shtetit ligjor, si dhe hierarkisë së akteve dhe organeve.

22. Në mbështetje të pretendimeve të tyre, kërkuesit, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se nuk kanë marrë përgjigje përfundimtare nga gjykatat për themelin e pretendimeve të tyre, për sa i përket kundërshtimit të veprimit përmbarimor të sekuestros së sendeve të luajtshme dhe pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë (vendimeve nr. 15, datë 11.08.1999 dhe nr. 2, datë 07.09.2009 të administratorëve të përbashkët të shoqërisë në administrim). Sipas tyre, gjatë vazhdimit të gjykimit të çështjes në themel, Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin nr. 24, datë 09.05.2017, me të cilin ka rrëzuar padinë për shkak të parashkrimit, duke u mbështetur në arsyetim në vendimin e kundërshtuar të saj nr. 49, datë 15.12.2016. Po ashtu, sipas kërkuesve, gjykatat nuk kishin kompetencë lëndore për të gjykuar mosmarrëveshjen, e cila është me natyrë civile dhe jo administrative, sepse kërkimet lidhen me kundërshtimin e titullit ekzekutiv, që mbart një detyrim që buron nga kontratat e lidhura mes tyre, në të cilat palët kanë përcaktuar se në rast mosmarrëveshjeje ato do të zgjidhen nga Gjykata e Arbitrazhit të Huaj në Paris. Po sipas kërkuesve, Gjykata Administrative e Apelit nuk ka pranuar të shqyrtojë provat e rëndësishme të paraqitura nga ata, sikurse ishin vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë dhe të Gjykatës së Apelit Janinë,

që kanë arsyetuar se titujt ekzekutivë, për të cilët gjykatat shqiptare kanë lëshuar urdhrat për ekzekutimin e tyre, janë të paekzekutueshëm në territorin e Greqisë, duke iu mohuar kërkesve të drejtën e mbrojtjes.

23. Kolegji konstaton se, në thelb, pretendimet e kërkesve kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, pikërisht me kërkimet për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor për vendosjen e masës së sekuestros për sendet e luajtshme dhe pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë, vendimeve nr. 15, datë 11.08.1999 dhe nr. 2, datë 07.09.2009 të administratorëve të përbashkët të shoqërisë në administrim. Në fakt, këto kërtime janë ndarë nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila në procesin e kundërshtuar ka shqyrtuar vetëm kërkimin për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit/padisë, të cilin e ka rrëzuar, por vendimi i saj është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë dhe gjykimi i çështjes për një kërkim të tillë është pushuar. Nga ana tjetër, sikurse edhe vetë kërkesit në kërkesën e tyre ka parashtruar, se padia e themelit ka vijuar të shqyrtohet në një proces tjetër gjyqësor, në përfundim të të cilit Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë vendimin nr. 24 (86-2017-1981), datë 09.05.2017, me të cilin ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkesve, vendim kundër të cilit, referuar të dhënave në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, ata kanë ushtruar rekurs.

24. Për rrjedhojë, për sa kohë pretendimet në thelb të kërkesve kanë të bëjnë me themelin e mosmarrëveshjes, e cila është shqyrtuar në një proces të ndarë nga procesi gjyqësor i kundërshtuar, si dhe duke mbajtur parasysh se në përfundim të këtij të fundit është vendosur pushimi i gjykimit, Kolegji çmon se për pretendimet e ngritura, kërkesit nuk plotësojnë kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, ndërsa kanë ende mundësitë dhe mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtat të pretenduara si të cenuara, duke mos përjashtuar edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë në rast të një vendimi gjyqësor përfundimtar të pafavorshëm për ata, në lidhje me themelin e mosmarrëveshjes.

25. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**



Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.